

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. ANA GOLLOSHI

02/13/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 12.02.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Ana Gollosi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 13.02.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Ana Gollosi, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit .

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj. Pamela Qirko relatore, znj. Firdes Shuli anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.